


Shenjtori i ditës: Dëshmore Fotinia Samaritane - Oshënar Porfiri i Gazës



E premte, 26 shkurt 2021 – Shenjtori i ditës.

Dëshmoret Fotinia Samaritane, Anatolia. Oshënar Porfiri i Gazës. Dëshmor Theokliti.

– Dëshmore Fotinia Samaritane –

Shën Fotinia ishte gruaja nga Samaria, me të cilën Zoti ynë Jisu Krisht foli te pusi i Jakovit (Joan 4) dhe i zbuloi gjithçka që kishte bërë ajo që nga fëmijëria. Pasi ndryshoi mënyrën e jetesës, ajo shkoi për të shpallur Lajmin e Mirë në vendlindjen e saj dhe konvertoi në Krishterim katër motrat dhe dy bijtë e saj.

Pas martirizimit të apostujve Petro dhe Pavël gjatë persekutimit të Neronit (viti 54), ajo shkoi për të predikuar me sukses besimin në Kartagjenë, bashkë me të birin, Joseun.


Djali tjetër, Viktori, pasi luftoi trimërisht kundër avarëve, u emërua gjeneral dhe u dërgua nga perandori në Galile, me urdhrin për të vrarë të krishterët. Por ai, në vend që të ndëshkonte të krishterët, nxënësit e apostujve, predikonte gjatë gjithë kohës besimin e vërtetë dhe i nxiste besimtarët t'i qëndronin besnikë atij.

Madje konvertoi edhe dukën Sebastian, si edhe shumë dinjitarë të shtetit. Kur mësoi për këtë lajm, perandori i arrestoi të gjithë dhe i nxori para gjykatës së tij.

Por, kur e kuptoi se nuk do t'ia dilte mbanë të thyente vendosmërinë e tyre, dha urdhër që Viktorit e Joseut t'i këputnin krahët, deri në lartësinë e shpatullave, pastaj i burgosi.

Edhe shën Fotinën e nxorën para gjyqit, por ajo arriti të konvertonte me anë të fjalës bijën e perandorit dhe shërbëtoret e saj. Kjo gjë e zemëroi së tepërmi tiranin, i cili i hodhi të gjitha shenjtoret në furrën e zjarrtë. Me anë të Hirit të Perëndisë, ato mbetën të paprekura, prandaj iu nënshtruan torturave të shumta ku iu nxorën sytë. I flakën në një qeli të mbushur plot me gjarpërinj helmues. Atje iu shfaq Krishti në mes të një drite të shkëlqyer, i shoqëruar nga apostujt Petro dhe Pavël dhe nga një numër i madh engjëjsh të shenjtë. Ai i bekoji duke u thënë: "Paqe në të gjitha ju! Gëzohuni, sepse Unë jam bashkë me ju!". Ato morën forcën për të duruar vuajtjet dhe dhimbjet e burgimit për tre vjet dhe kështu sollën në besimin e vërtetë shumë paganë.

Kur i nxorën nga qelitë, që t'u bënë tortura të tjera, një engjëll i Perëndisë u shfaq dhe i mbrojti me krahët e tij. Më në fund, tirani urdhëroi që shën Fotinës t'i rripnin lëkurën dhe ta hidhnin në një pus të thatë. Të njejtën torturë urdhëroi dhe për bijtë e saj, ndërsa Sevastianin, pasi i prenë organet gjenitale, e mbyllën në një banjë të infektuar publike. Pastaj urdhëroi t'u prisnin gjinjtë shenjtoreve të tjera dhe t'i rripnin të gjalla. Fotidën e lidhën nga duart midis dy pemëve të përkulura me forcë, të cilat e shqyen kur shkuan në pozicionin e tyre të natyrshëm. Në këtë mënyrë, me anë të këtyre torturave të tmerrshme, shpirtrat e martirëve të shenjtë u larguan së bashku nga kjo jetë për të jetuar në Mbretërinë e Qiejve.



* * * * *

– Oshënar Porfiri i Gazës –

Kur persekutimet reshtën dhe Krishterimi u njoh si fe zyrtare e shtetit, pasuesve të apostujve iu desh shumë punë dhe mundime për të çrrënjësuar paganizmin, shpesh agresiv, dhe të punonin që mes njerëzve të mbizotëronte ëmbëlsia e zakoneve të krishtera. Jeta e oshënar Porfirit është një dëshmi e mrekullueshme e ecurisë së këtij ndryshimi të madh.

Shën Porfiri lindi në vitin 347, në një familje fisnike e të pasur të Thesalonikës. I pushtuar nga dëshira hyjnore, la një ditë atdheun dhe pasuritë e tij dhe shkoi drejt shkretëtirës së famshme të Skitës, në Egjipt. Mori shpejt veshjen engjëjllore dhe

jetoi pesë vjet në shoqërinë e etërve që shkëlqenin atje në atë kohë. Prej andej shkoi në Palestinë, ku jetoi edhe pesë vite të tjera në një gropë në shkretëtirën e Jordanit. Për shkak të thatësisë së madhe dhe ashpërsisë së klimës, u sëmur rëndë. Duke pasur shpresë vetëm te Perëndia, shkoi në Jerusalem dhe, i mbështetur mbi një shkop, nderoi Vendet e Shenjta. Atje lidhi miqësi me Markun, biografin e jetës së tij, dhe e ngarkoi të shkonte në Thesalonikë për të ndarë pasurinë midis vëllezërve.

Kur u kthye, Marku e gjeti Porfirin plotësisht të shëruar pas një ekstaze që pati në Golgotha, gjatë së cilës kishte parë Kusarin e Mirë që zbriti nga Kryqi dhe e çoi pranë Krishtit, i Cili i dorëzoi Kryqin e Shenjtë.

Pasi ndau trashëgiminë të të varfrit e Jerusalemit dhe në manastiret e Egjiptit, Porfiri nisi të ushtronte zanatin e këpucarit për të jetuar me punën e duarve të tij, sipas shembullit të apostull Pavlit. Kur mbërriti në moshën 45 vjeçare, episkopi i Jerusalemit, Praili, meqenëse kishte dëgjuar për mirësinë e tij, dashurinë për të varfrit dhe për dhuratat e interpretimit të Shkrimit të Shenjtë, e hirotonisi prift, edhe pse ai nuk donte, dhe i dorëzoi në ruajtje Drurin e Çmuar të Kryqit të Shpëtimtarit (Stavrofylaks). Ky nder, që e kërkonin shumë veta, nuk e ndryshoi sjelljejen e Porfirit, por shenjtë vazhdonte të jetonte me privime, duke i kaluar të gjitha netët në agripni të shenjta. Gjatë kohës që ushtronte këtë shërbesë, për tre vjet me radhë, ndërroi jetë episkopi i Gazës. Besimtarët e kësaj Kishe, të themeluar në kohët e para, por që nuk kishte madhësi dhe shtrirje të rëndësishme, duke mos arritur të binin dakord për zgjedhjen e një pasuesi, dërguan një delegacion pranë kryepiskopit të Qesarisë, Joanit. Pas një kreshme treditore, Zoti iu sugjeroi Porfirin, si personin më të përshtatshëm për këtë detyrë. Duke njohur përlësinë e Skevofilaksit, Joani e thirri në Qesari me pretekstin për t'i shpjeguar një frazë nga Shkrimi i Shenjtë. Porfiri, i lajmëruar një natë më parë nga Zoti Jisu Krisht, që vajti për t'i dorëzuar një nuse të përlur, por të virtytshme, “motrën” e tij, i shqetësuar, i bëri të ditur Markut: “Unë e di mirë se në dëshirën time për të shlyer mëkatet e mia, nuk mund të më imponohet shlyerja e mëkateve të të tjerëve. Por është e pamundur t'i kundërvihesh vullnetit të Perëndisë”.

Pasi mbërriti në Qesari, u zgjodh nga episkopi, me gjithë të qarat dhe kundërshtitë e tij, pas një agripnie të së dielës, dhe u mor menjëherë prej besimtarëve.

Mbërriti me shumë mund në Gaza, sepse idhujtarët vendas e kishin mbushur rrugën me pengesa të ndryshme, me gjemba dhe papastërti të ndryshme me erë të keqe.

I nënshtruar ndaj vullnetit të Perëndisë dhe duke kryer me kurajë të madhe luftën e

tij kundër djallit, qëkurse mbërriti në qytet për herë të parë, ku mbizotëronte prej kohësh një thatësirë e madhe, i mblodhi të krishterët, që nuk ishin më tepër se 280 veta dhe caktoi të bëhej agripni për tërë natën. Në mëngjes, pas një litanie që kaloi nëpër të gjithë qytetin, Perëndia bëri edhe një herë tjetër mrekullinë e profetit Ilia, duke sjellë shi të bollshëm. Në atë çast u konvertuan 127 paganë, duke thirrur: “Vetëm Krishti është Perëndi! Vetëm Ai ka fituar!”. Me gjithë këto mrekulli dhe lutjet e Porfirrit për kthimin e tyre në Krishterim, paganët që mbanin pushtetin në qytet nuk e reshtën persekutimin e tyre dhe sulmet e dhunshme kundër episkopit të shenjtë dhe besimtarëve. Prandaj Porfiri vendosi të dërgonte Markun në Konstandinopojë, për t’ia paraqitur sovranit kërkesën e tij nëpërmjet ndërmjetimit të shën Joan Gojartit. Mori një edikt të perandorit Arkad, që urdhëronte mbylljen e të gjithë tempujve paganë. Por ky dekret nuk u zbatua në mënyrë rigoroze dhe fyerjet e sulmet e paganëve idhujtarë kundër të konvertuarve e shtynë shën Porfirin të shkonte në Qesari, për t’i kërkuar kryepiskopit me përgjëratë dorëheqjen e tij. Joani e nxiti të kishte durim dhe i propozoi të shkonin së bashku në Konstandinopojë, për t’i kërkuar perandorit shkatërrimin e tempujve paganë.

Pasi morën këshilla të ndriçuara nga një eremit i quajtur Prokop, gjatë një qëndrimi të shkurtër të anijes në ishullin Rodos, ata arritën në Bizant dhe shkuan menjëherë për t’i bërë nderimet e duhura shën Joan Gojartit. Shën Joani tregoi dhembshuri të madhe, por, duke mos mundur të ndërmjetonte në favor të tyre pranë perandorit, sepse perandoresha e fuqishme, Evdhoksia, ishte irrituar kundër tij, i kërkoj oborrtarit Amantios që të ndërhynte. Evdhoksia, që ishte shtatzënë në atë kohë, i pranoi të dy episkopët me simpati dhe u premtoi mbështetjen e saj. Pas disa ditësh, ajo lindi djalë, i cili do të ishte perandori i ardhshëm Theodhosi II i Riu (408-450), në përputhje me profecinë e bërë nga dy hierarkët. Në shenjë mirënjohjeje, ajo u tha që ta hartonin ata vetë kërkesën e tyre në lidhje me kishën e Gazës. Ditën e pagëzimit të fëmijës, në mes të festimeve madhështore për këtë ngjarje, Evdhoksia mori nga perandori miratimin e tij dhe bëri planet, si dhe ofroi shpenzimet për ndërtimin e një kisha madhështore mbi rrënojat e një tempulli pagan në Gaza. Pas Pashkës (402), Porfiri dhe Joani morën rrugën e kthimit, në shoqërinë e funksionarëve perandorakë të dërguar për të parë zbatimin e urdhrave të sovranit.

Kur mbërritën në Majuma, pasi i shpëtuan mrekullisht një stuhie të tmerrshme dhe kthyen në besën e vërtetë kapitenin e anijes, pohues i arianizmit, të dy episkopët u pritën me himne nga të krishterët. Kur kortezhi mbërriti në Gaza, një statujë e Afërditës u bë copë e thërrime kur pranë saj kaloi emblema e Kryqit të Nderuar. Besimtarët shpërthyen në brohoritje të forta para kësaj mrekullie të madhe dhe magjistrati perandorak, që mbërriti atje në krye të një eskorte të fortë ushtarake,

lexoi vendimin e perandorit. Më pas, në zbatim të ediktit perandorak, u shkatërruan tetë tempuj paganë. Pjesa tjetër e paganëve, rreth 300, iu bashkua besimit të vërtetë dhe Porfiri, pasi i katekizoi sipas rregullit, i pagëzoi.

Me vendosjen e paqes në Gaza, episkopi i shenjtë punoi shumë për ndërtimin e një kishe të madhe mbi gërmadhat e tempullit Marnion, sipas planeve të dërguara nga perandoresha. Të gjithë besimtarët, burra e gra, morën pjesë me entuziazëm në punime, duke psalur himne dhe duke thënë me zë të lartë: “Krishti fitoi!”. Pas një pune pesëvjeçare, ditën e Pashkës, u krye shenjtërimi i Kishës, e quajtur Evdhoksiana, në praninë e murgjve të ndodhur atje rrotull dhe të një numri të madh besimtarësh. Këto kremtime ishin për shenjtorin një rast për t’u shpërndarë lëmosha të shumta besimtarëve dhe për ta nxitur popullin të qëndronte i palëkundur në besimin e vërtetë. Por, me gjithë këto ngjarje, paganët nuk reshtën së bëri rezistencë dhe në çdo rast kërkonin shkak për t’u grindur me të krishterët dhe një ditë, pasi shpërtheu një zënkë e madhe, ata vranë shtatë besimtarë dhe ndoqën shën Porfirin, i cili shpëtoi duke kaluar nga një çati në tjetrën.

Disa vjet më vonë, pasi u vendos rregulli në komunitetin e krishterë të Gazës, shën Porfiri, që kishte dhënë ndihmën e tij edhe në mbrojtjen e besimit të vërtetë kundër herezisë pelagiane, duke marrë pjesë në Sinodin e Diopolis (415), u sëmur dhe zuri shtratin. Ai hartoi një dhiatë ku linte si porosi dhënien e rregullt të lëmoshave për të varfrit dhe mikpritjen për të huajt dhe ia besonte Perëndisë të gjithë grigjën e tij të krishterë. Më 26 shkurt 420, fjeti në paqe, duke iu bashkuar korit të shenjtorëve dhe duke përmbushur kështu 25 vjet në krye të episkopatës dhe të përpjekjeve të pareshtura kundër idhujtarisë.